

VENDIM
Nr.6, datë 16.2.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË ERE-S NR 14 , DATË
11.7.2003 “LIDHUR ME KËRKESËN E BËRË NGA EMIKEL SHPK PËR MARRJE
LICENCE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 11 të ligjit nr. 7973, datë 26.07.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, si dhe të nenit 4 të Marrëveshjes koncensionare që shoqëria “Emikel” sh.p.k. ka lidhur me Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.02 .2006, në kuptim edhe të sa ka vendosur dhe Këshilli Drejtues i ERE-s në mbledhjet e tij të datave 30.06.2003 dhe 11.07.2003

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Drejtues të ERE-s nr.14, datë 11.07.2003 “Lidhur me kërkesën e bërë nga “Emikel” sh.p.k. për marrje licence për prodhimin e energjisë elektrike”, pika 1 ndryshohet si më poshtë :

- Të miratojë dhënien e licencës Emikel 2003 sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralet vendore Lenie, Çorovodë dhe Tuçep.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema